

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**LIRANDA SH.P.K**

Sot, me date 10 Nentor 2023 Golem zona kadastrale 1791 nr. Pasiuris 136/244 Golem ,Kavaje, Tirane Shqipëri, është present presoni fizik, Z. Jahë Jaha, , lindur më 20.01.1956 në Shishman , dheBanues në Gjermani, me adres 2219 Hamburg, Schiffbeker Weg195, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal kartë identiteti nr. ID 103127 dhe numer personal L1TVFY1MW, e lëshuar më datë 31.07.2023 dhe e vlefshme deri më datë 30.07.2033

Personi si më sipër i cilësuar dhe i përfaqësuar ka deklaruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, themelimin e një shoqërie në bazë të ligjit n. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe si pasojë edhe redaktimin e Aktit të Themelimit. Aktiviteti i kësaj shoërie do të rregullohet nga statuti, pjesë plotësuese e këtij akti themelimi të aprovuar dhe të nënshkruar rregulishtë nga ortaku si më posht vijon:

**NENI 1**

Themelohet shoqëria e emëruar **LIRANDASH.P.K.**, më poshtë e quajtur edhe shoqëria. Shoqëria është objekt i ligjit shqiptar, ndërsa filialet qe mund te krijohen do te jene objekt i ligjit te vendit ku ato do te kenë selinë. Shoqëria do te ushtroj aktivitetin e saj ne baze te këtij akti themelimi dhe ne baze te Statutit te saj te miratuar nga ortaket.

**NENI 2**

**SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqërisë është në Golem zona kadastrale 1791 nr. Pasiuris 136/244 Golem ,Kavaje, Tirane Shqipëri


**NENI 3**

**OBJEKTI I SHOQERISE**

Aktivitete ne fushen e turizmit ,ndertimit , ndertim objektesh civile dhe publike, vepra arti, rruge etj, nyje betoni , prodhim inertesh, tregtim me shumice dhe pakice te lendeve te ndryshme qe sherbejne ne ndertim si, hekur, çimento, llaç i pergatitur etj. Import eksport i materialeve te ndryshmeShoqëria ka për objekt aktivitetin e import e manaxhimit dhe përpunimit të të dhënave kompjuterike në cdo lloj forme dhe në cdo lloji formati.

Përpilimi i projekteve të ndryshme me qëllimin pëfitimin e investime në fusha të ndryshme nga donator publik vendas ose të huaj si dhe duke kërkuar investitor persona fizik ose juridik vendas ose të huaj.

Krijimi i start Up-eve të cdo lloj fushe duke dhënë konsulencën e nevojshme investitorëve vendas ose të huaj.Objekti social mund të zhvillohet në mënyre direktet por edhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara ose të lidhura që zhvillojnë aktivitet e renditura më sipër. Import – eksport te autoveturave , Shit blerje te pasurive te paluajtshme.



#### **NENI 4**

Për zhvillimin e aktivitetit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me persona fizik dhe juridik, të vendit ose të huaj.

#### **NENI 5**

##### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqëria, ka një kohëzgjatje pa afat dhe do të marrë personalitet në momentin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB) Tirane.

#### **NENI 6**

##### **KAPITALI THEMELTARE I SHOQERISE**

Kapitali themeltarë i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetëmijë) Lekë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë.

Kapitali themeltarë i shoqërisë është i përbërë nga kuota që i përkasin ortakëve të renditur si më poshtë:  
Oratku themelues: Z. Jahë Jaha, , lindur më 20.01.1956 në Shishman, dhe banues në Gjermani, me adresë 2219 Hamburg, Schiffbeker Weg 195, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal kartë identiteti nr. ID 103127 dhe numer personal L1TVFY1MW, e lëshuar më datë 31.07.2023 dhe e vlefshme deri më datë 30.07.2033, i cili do të zotërojë 1 (një) kuotë me një vlerë totale prej Lekë 10.000 (dhjetëmijë) e cila do të përbëjë 100 % (njëqind për qind) të kapitalit themeltarë të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zvogëlohet ose mund të rritet dhe është plotësisht i likuiduar dhe i nënshkruar.

#### **NENI 7**

Ortakët e shoqërisë marrin përgjegjësinë për të rritur volumin e punëve në shoqëri, të respektojnë detyrimet për sa i përket ruajtjes të sekretit që janë të lidhura me tipin e aktivitetit tregtar që do të zhvillohet nga shoqëria dhe të mos dëmtojnë interesat e vet shoqërisë, duke u angazhuar që të mos themelojnë në Shqipëri aktivitete konkurruese me objektin e shoqërisë.

#### **NENI 8**

##### **DREJTIMI I SHOQERISE**

Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Jahë Jaha, , lindur më 20.01.1956 në Shishman, dhe banues në Gjermani, me adresë 2219 Hamburg, Schiffbeker Weg 195, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal kartë identiteti nr. ID 103127 dhe numer personal L1TVFY1MW, e lëshuar më datë 31.07.2023 dhe e vlefshme deri më datë 30.07.2033

Administratori, Z. Jahë Jaha, emërohet për 5 (pes) vjet duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, me të drejtën për tu rizgjedhur, nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos që ta shkarkoj atë nga kjo detyrë para përfundimit të këtij mandati, ose në rastin e paraqitjes me përpara të dorëheqjes nga ana e administratorit sipas procedurave të parashikuara nga ligji.

Të gjithë personat ortak ose jo ortak që ushtrojnë detyrën e administratorit do të aplikojnë politikat tregtare të vendosura nga ana e asamblesë së përgjithshme në bazë të ligjit shqiptar.



**NENI 9**

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakeve të saj. Asambleja e përgjithshme vendos në baze të ligjit shpërndarjen ose investimin e fitimeve duke vendosur dhe mënyrat.

**NENI 10**

Asambleja e përgjithshme emëron ose revokon Administratorët që janë në detyrë dhe mund të emërojnë dhe administratorë të tjerë duke i shtuar atyre ekzistues dhe me kompetenca të përcaktuara në baze të ligjit.

Administratori do të ushtroje të gjitha kompetencat e përcaktuara nga ligji, për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, do të përfaqësojë shoqërinë në raportet me të tretet me përjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti i jep ortakeve shprehimisht.

Kompetencat e administratorit janë vendosur në Statutin e Shoqërisë, në baze të ligjit.

Për çeshtje të një rëndësie të vecante, administratori konsultohet me ortaket dhe aplikon vendimet e marra nga asambleja e ortakeve, të marra me shumicën e parashikuar nga ligji.

**NENI 11**

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve do të zgjidhen në bazë të nenit 30 të Statutit të Shoqërisë.

**NENI 12**

Shoqëria ka vulën e saj me permesa të përgjithshme, e realizuar sipas dispozitive ligjore në fuqi dhe mund të ketë edhe një markë të veten.

**NENI 13**

Shoqëria deklorohet e themeluar në aplikim të plotë të normave të Statutit dhe në baze të normave ligjore shqiptare dhe në veçanti me ligjin n. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

10 Nentor 2023

LIRANDA SH.P.K

ORTAKU

Z. Jahë Jaha

